



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës Banka dhe Sigurime

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Banka dhe Sigurime
Niveli:	Bachelor
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (semester V)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda përfshin njohuritë themelore për Bankat dhe sigurimet në kushtet bashkëkohore. Pjesa e parë e kësaj lënde trajton afarizimin e bankave, rreziku bankar, sistemet bankare në vendet e zhvilluara dhe vendet në tranzicion, politikat afariste të bankave si dhe potencialin financiar dhe kreditor të bankar. Pjesa e dytë e lëndës trajton riskun, aplikimet dhe përzgjedhjen e sigurimeve, identifikimin e riskut sipas llojeve, matjen, menaxhimin dhe sigurimin e riskut.
Qëllimet e lëndës:	Të pajisë studentët me njohuritë themelore mbi Bankat dhe afarizmin e bankave në kushtet bashkëkohore; - Të aftësojë studentët për analizën dhe njohjen e problemeve të bankave në kushtet bashkëkohore të afarizmit dhe të konkurrencës gjithnjë në rritje; - Të mundësojë zbatimin e njohurive të fituara edhe në rrethanat aktuale të afarizmit bankave,; - T'i aftësojë studentët për ballafaqimin me problemet praktike dhe të mundësojë zgjidhjen e atyre problemeve duke u bazuar në njohuritë e fituara gjatë vijimit të kësaj lënde. Gjithashtu kursi ofron njohuri mbi: Sigurimin e riskut, sigurimet jetësore, shëndetësore, të pronës dhe shpërndarjen e riskut dhe përgjegjësi

Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të ciklit të ligjëratave dhe ushtrimeve nga kjo lëndë, studentët duhet të jenë të aftë: - Të kuptojnë afarizmin bankave afariste; - Të analizojnë drejt problemet praktike të bankave dhe të njohin problemet me të cilat ato ballafaqohen; - Të jenë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikojnë në afarizmin e bankave; Zgjerojnë njohuritë për mënyrat e vlerësimit të risqeve dhe sigurimin e tyre; Thellimin e njohurive për përcjelljen dhe klasifikimin e risqeve; Thellimin e njohurive për menaxhimin e riskut përmes sigurimeve, etj.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve)		

	lidhur me temën e ligjëruar
Metodat e vlerësimit:	• Punimi seminarik dhe prezentimi: 0-20% • Kollokviumi i parë: 0-40% • Kollokviumi i dytë: 0-40% ose • Provimi përfundimtar 0- 80%
Literatura	
Literatura bazë:	▪ Prof.Dr.Gazmend Luboteni, Bankat dhe afarizmi bankar, Prishtinë, 2006. ▪ Ksenija Klasiq Ivo Andrijaniq – Bazat e Sigurimeve – parimet dhe praktika, Prishtinë, 2009.
Literatura shtesë:	▪ Barbara Casu & Claudia Girardone & Phillip Molineux – Hyrje në sektorin bankar, Ars Lamina, 2013. ▪ Timothy W. Koch & S. Scott MacDonald – Bank Management, 7 Edition
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezentimi i syllabusit të lëndës
Java e dytë:	Hyrje në afarizmin bankar
Java e tretë:	Bankat bashkëkohore dhe rreziku afarist
Java e katërt:	Sistemet bankare në vendet e zhvilluara
Java e pestë:	Sistemet bankare në vendet e tranzicionit
Java e gjashtë:	Politika afariste e bankave. Parimet e afarizmit bankar.
Java e shtatë:	Potenciali financiar dhe kreditor i bankave
Java e tetë:	Kollokviumi i parë
Java e nëntë:	Kreditimi me afat të shkurtër dhe të gjatë
Java e dhjetë	Hyrje në sigurime
Java e njëmbëdhjetë:	Organizimi i sigurimeve në Kosovë
Java e dymbëdhjetë :	Korniza juridike e afarizmit të sigurimeve

Java e trembedhjetë:	Llojet e sigurimit
Java e katërbëdhjetë:	Risigurimi. Teknikat e përpunimit të policave të sigurimit.
Java e pesëmbëdhjetë:	Kollokviumi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së. • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim; • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. • Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.